



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:005912 C. nr. 62/2021
Datë: 11.02.2025
Numri i dokumentit: 06832702

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësit Y.U. nga fshati Komuna e Mitrovicës, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati O.H. nga Mitrovica, kundër të paditurit B.R. nga prizreni, për kompensim dëmi, jashtë seance, me datë 11 Shkurt 2025, morri këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë padia në këtë çështje kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësja Y.U. nga fshati Komuna e Mitrovicës, përmes të autorizuarit të vet, ka paraqitur padi kundër të paditurit B.R. nga Prizrei, për kompensim dëmi, duke kërkuare nga gjykata të detyron të paditurit të kompensojnë dëmin material në shumën 3.000,00 €, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve.

Padisë si provë ka paraqitur aktgjykimin PKR. nr. 66/2018 datë 09.01.2020, me të cilin paditësit janë shpallur fajtor dhe njëkohësisht si dënim plotësues janë detyruar të kompensojnë të gjithë të dëmtuarit.

Ky aktgjykim pjesërisht është prishur dhe kthyer në rigjykim. Mirëpo pjesa e dënimit plotësues, në rastin konkretë pjesa ku si dënim plotësues kundër të akuzuarit B.R. me të cilin i akuzuari është detyruar që palët e dëmtuara t'i kompenzon, është vërtetuar dhe ajo pjesë e aktgjykimit është e plotfuqishme.

Në atë pjesë, përkatësisht në faqen 10 të aktgjykimit, në paragrafin e dytë, ndër tjerë, gjykata ka vendosur që këtu paditësin Y.U. sipas numrit rendor 28, ta kompenzon në shumën 3.000,00 €.

Pasi që në rastin konkretë kemi të bëjmë me çështje të gjykuar pasi që në lëndën penale i padituri Besim Rexhaj është shpallur fajtor, me aktgjykim është detyruar të kompensojnë të gjithë palët e dëmtuara e gjithashtu edhe paditësin Y.U.

Pasi që në rastin konkretë palës paditëse, në lëndën penale PKR. nr. 66/2018 i është njohur e drejta në kompensim si dënim plotësues në atë lëndë, gjykata në kuptim të nenit 391 par. 1 germa (c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi që të hedhë padinë si të palejueshme.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

C. nr. 62/2021 datë 11 Shkurt 2025

Gj y q t a r i
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur mund të ushtron ankesë, në Gjykatën Apelit në Prishtinë, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.